

RELACION
PËR
PROJEKT-UDHËZIMIN

**“PËR MIRATIMIN E FORMATIT TË KËRKESËS, LLOJET E DOKUMENTEVE QË
PARAQITEN PËR SHPALLJEN OSE NJOHJEN E STATUSIT “DËSHMOR I
ATDHEUT”, SI DHE KUSHTET TEKNIKE TË PLOTËSIMIT TË TYRE”**

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projekt-udhëzim ka për qëllim miratimin e formatit të kërkesës, llojet e dokumenteve që paraqiten për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut”, si dhe kushtet teknike të plotësimit të tyre.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE
DOKUMENTEVE TË TJERA POLITIKE**

Ky projektakt ka karakter teknik dhe nuk lidhet me programin politik të Këshillit të Ministrave dhe as me dokumente të tjera politike.

Projektvendimi nuk është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve, për Ministrinë e Mbrojtjes, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 862, datë 27.12.2022, për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2023.

**III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË,
PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Ky projekt-udhëzim ka për qëllim unifikimin e dokumentacionin që duhet të paraqitet për marrjen e statusit “Dëshmor të atdheut”, të cilat do të shqyrtohen nga komisionet vendore pranë këshillave të qarqeve, këshillave bashkiakë dhe prefektëve, si dhe Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”.

Objekti i këtij projekt-udhëzimi është përcaktimi i formatit të kërkesës, llojet e dokumenteve që duhet të paraqiten për marrjen e statusit “Dëshmor i atdheut” dhe kushtet teknike të plotësimit të tyre.

**IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI
ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS DHE NDËRKOMBËTAR**

Ky projektakt është në përputhje të plotë me rendin juridik të brendshëm.

Projektakti është hartuar në mbështetje të pikës 2, të nenit 9, të ligjit nr. 109/2018 “Për statusin e “Dëshmorit të atdheut”.

V. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Relacion për projekt-udhëzimin “Për miratimin e formatit të kërkesës, llojet e dokumenteve që paraqiten për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut”, si dhe kushtet teknike të plotësimit të tyre”.

Projekt-udhëzimi është i ndarë në 11 krerë dhe përbëhet nga 28 nene.

1. Kreu I, i cili përbëhet nga tri nene, përfshin "Dispozitat e përgjithshme" përmbledh qëllimin e këtij projekt-udhëzimi, objektivat, subjektet e aktit, si dhe përkufizimet.

- Neni 1: Parashikon formatin e kërkesës, llojet e dokumenteve që duhet të paraqiten për statusin "Dëshmor i atdheut" dhe kushtet teknike të plotësimit të tyre dhe synon unifikimin e dokumentacionin që duhet të paraqitet për statusin "Dëshmor i atdheut".

- Neni 2: Parashikon subjektet e projekt-udhëzimit. Lind nevoja e përcaktimit të saktë të subjekteve që preken nga ky projekt-udhëzim.

- Neni 3: Saktësohet përkufizimi i 38 termave të cilët janë për efekt të zbatimit të këtij projekt-udhëzimi.

2. Kreu II i cili përbëhet nga dy nene, parashikon objektet e kërkesës dhe organet ku drejtohet.

- Neni 4 përcakton objektet e kërkesës për statusin e "Dëshmorit të atdheut".

- Neni 5 përcakton organet ku paraqitet kërkesa për statusin e "Dëshmorit të atdheut".

3. Kreu III i cili përbëhet nga dy nene, përmban subjektet kërkuese dhe formatin e kërkesës.

- Neni 6 përcakton subjektet dhe kushtet që duhet të plotësojnë për të paraqitur kërkesën për statusin e "Dëshmorit të Atdheut"

- Neni 7 përcakton formatin e kërkesës e cila është sipas shtojcës 1, bashkëlidhur projekt-udhëzimit.

4. Kreu IV i cili përbëhet nga gjashtë nene, përmban dokumentet shoqëruese të formatit të kërkesës për statusin "Dëshmor i atdheut".

- Neni 8 përcakton listën e dokumenteve shoqëruese me karakter të përgjithshëm të kërkesës, të cilat duhet të shoqërojnë për çdo rast kërkesën sipas objektit, që plotësohet nga subjekti kërkuës. Me synim shmangien e konfuzionit, është bërë lista e dokumenteve me karakter të përgjithshëm që paraqitet në çdo rast nga subjekti kërkuës.

Nenet në vazhdim 9, 10, 11, 12, 13 do të përcaktojnë dokumentet shoqëruese që paraqiten nga subjekti kërkuës, sipas veçorisë së objektit.

- Neni 9 përcakton dokumentet që paraqiten për njohjen e statusit "Dëshmor i atdheut" për shtetasit shqiptarë dhe të huaj të cilët janë shpallur "dëshmor" nga organet shtetërore, përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 8607, datë 27.04. 2000 "Statusi i dëshmorit të atdheut", të ndryshuar, ku përveç dokumenteve me karakter të përgjithshëm (neni 8) përcakton dokumentet shoqëruese që i bashkëlidhen kërkesës (shtojca 1) nga subjekti kërkuës.

Relacion për projekt-udhëzimin "Për miratimin e formatit të kërkesës, llojet e dokumenteve që paraqiten për shpalljen ose njohjen e statusit "Dëshmor i atdheut", si dhe kushtet teknike të plotësimit të tyre".

- Neni 10 përcakton dokumentet që paraqiten për shpalljen “Dëshmor i atdheut” të personit me veprimtari para datës 28 nëntor 1912 dhe dokumentet për shpalljen “Dëshmor i atdheut” të shtetasit shqiptar dhe të huaj me veprimtari nga data 28 nëntor 1912 deri më 7 prill 1939, ku përveç dokumenteve me karakter të përgjithshëm (neni 8), përcakton dokumentet shoqëruese që i bashkëlidhen kërkesës (shtojca 1) nga subjekti kërkuar.
- Neni 11 përcakton dokumentet që paraqiten për shpalljen “Dëshmor i atdheut” të shtetasit shqiptar apo të huaj i cili ka marrë pjesë me armë në dorë ose në formë të organizuar në LANÇ dhe ka rënë duke luftuar dhe për shtetin shqiptar, ka qenë pjesëtar i formacioneve të Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe ka rënë në luftë jashtë kufijve shtetërorë të Shqipërisë deri më 9 maj 1945; të shtetasit shqiptar i cili ka qenë pjesëmarrës në formacionet e rregullta të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, i cili ka humbur jetën brenda datës 9 maj 1947, për shkak të sëmundjeve dhe plagëve të marra ose fatkeqësive të ndryshme, duke qenë në krye të detyrës luftarake; të shtetasit shqiptar i cili është ekzekutuar ose ka vdekur në burgjet dhe kampet e përqendrimit nazifashist apo ka vdekur si pasojë e plagëve apo sëmundjeve të ndryshme të marra në këto vende deri më 9 maj 1947; të shtetasit shqiptar i cili është pushkatuar për pjesëmarrjen në formacionet luftarake të LANÇ-it apo për mbështetje të pjesëmarrësve të Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar, si dhe të pushkatuar për hakmarje nga pushtuesit nazifashistë dhe bashkëpunëtorët e tyre nga data 7 prill 1939 deri më 29 nëntor 1944; të shtetasit shqiptarë pjesëmarrës në formacionet e Ushtrisë Nacionalçlirimtare që janë ekzekutuar me vendime të gjyqeve partizane për shkelje të moralit partizan dhe më vonë ka rezultuar që gjykimi ka qenë i pa mbështetur në prova. Për rastet e këtyre objekteve të kërkesës, përveç dokumenteve me karakter të përgjithshëm (neni 8), neni 11 përcakton dhe dokumentet shoqëruese që duhet të paraqesë subjekti kërkuar në secilin rast.

- Neni 12 përcakton dokumentet që paraqiten për shpalljen “Dëshmor të atdheut” të shtetasit shqiptar që ka rënë në luftë për pavarësinë e Kosovës dhe për të drejtat kombëtare në konfliktet e tjera etnike të zhvilluara në Ballkan, ku përveç dokumenteve me karakter të përgjithshëm, përcakton dhe dokumentet shoqëruese që duhet të paraqesë subjekti kërkuar bashkëlidhur kërkesës (shtojca 1).

- Neni 13 përcakton dokumentet që paraqiten për shpalljen “Dëshmor të atdheut” të shtetasit shqiptar i cili ka qenë ish-ushtarak apo punonjës civil i strukturave të Forcave të Armatosura dhe Ministrisë së Mbrojtjes dhe ka humbur jetën në krye të detyrës dhe për shkak të detyrës; të shtetasit shqiptar i cili ka qenë punonjës i strukturave të Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Brendshme dhe ka humbur jetën në krye të detyrës dhe për shkak të detyrës; të shtetasit shqiptar i cili ka qenë ose është nga shoqëria civile, dhe ka humbur jetën ose që e humbet jetën në përpjekje për të ndihmuar popullsinë në raste fatkeqësive natyrore, për mbrojtjen e pronës publike ose për shpëtimin dhe mbrojtjen e jetës së individit nga krimi; të shtetasit shqiptar i cili është vrarë gjatë tubimeve paqësore dhe pa armë për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut ose që kanë humbur jetën në krye të detyrës në mbrojtje të procesit zgjedhor pas datës 8 dhjetor 1990; të shtetasit shqiptar i cili vritet nga forcat apo elementët antishqiptarë në mbrojtje të flamurit, simboleve kombëtare dhe manifestimit të ndjenjave kombëtare.

Relacion për projekt-udhëzimin “Për miratimin e formatit të kërkesës, llojet e dokumenteve që paraqiten për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut”, si dhe kushtet teknike të plotësimit të tyre”.

Për rastet e këtyre objekteve të kërkesës, përveç dokumenteve me karakter të përgjithshëm (neni 8), neni 13 përcakton dhe dokumentet shoqëruese që duhet të paraqesë subjekti kërkues në secilin rast.

5. Kreu V përbëhet nga dy nene dhe përcakton mënyrën e paraqitjes së kërkesës dhe afati i shqyrtimit të saj, si dhe komisionet vendore që ngrihen pranë këshillit të qarkut, këshillit të bashkisë apo prefektit mënyrën e paraqitjes së kërkesës dhe afatin e shqyrtimit të saj.

- Neni 14 përcakton procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe e regjistrimit të saj pranë komisionit vendor për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut”, i cili është ngritur pranë këshillit të qarkut, këshillit bashkiak ose prefektit, që ka juridiksion administrativ në territorin ku ka vendbanimin familja e personit, për të cilin kërkohet të shpallet “Dëshmor i atdheut” ose t’i njihet statusi “Dëshmor i atdheut, i cili nëse konstaton se dokumentacioni i dorëzuar ka mangësi, sipas përcaktimit të këtij udhëzimi, ia kthen për plotësim subjektit kërkues.

- Neni 15 përcakton afatet e shqyrtimit të kërkesës dhe procedura e dërgimit të propozimit nga këshilli i qarkut, këshilli i bashkisë apo prefekti. Në lidhje me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për statusin “Dëshmor i atdheut”, si dhe dërgimin e propozimit pranë KQSDA-së, ishte e nevojshme të përcaktoheshin saktë dhe të detajuara rregullat dhe afatet që duhen të ndiqen.

6. Kreu VI përmban një nen dhe përcakton organet propozuese për statusin e “Dëshmorit të atdheut”.

- Neni 16 përcakton organet propozuese (subjektet) të cilët kanë të drejtë të dërgojnë propozimet për shpalljen “Dëshmor të atdheut” apo njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut” pranë Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”.

7. Kreu VII përmban një nen dhe përcakton dokumentacionin propozues që dërgohet pranë KQSDA-së.

- Neni 17 përcakton dokumentacionin që duhet të dërgohet në KQSAD nga organet propozuese, si këshilli i qarkut, këshilli bashkiak apo prefekti. Gjithashtu është e përcaktuar qartë dhe dokumentacioni që duhet të dërgohet pranë KQSAD-së nga ministri përkatës si organ propozues për rastet kur shtetasi i huaj për të cilin propozohet shpallja “Dëshmor i atdheut” është pjesëtar i formacioneve në ndihmë të Forcave të Armatosura të Shqipërisë apo Policisë së Shtetit Shqiptar, të cilët humbin jetën në krye të detyrës, në ndihmë të popullsisë apo në përpjekje kundër terrorizmit ose krimit ndaj jetës individit, kur shtetasi i huaj është pjesëtar i formacioneve ushtarake të NATO-s, në ndihmë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që humbet jetën në krye të detyrës, në mbrojtje të integritetit territorial të Republikës së Shqipërisë, si dhe shtetasi shqiptar bie në krye të detyrës me mision në mbështetje të paqes e të sigurisë së popujve të tjerë.

8. Kreu VIII përmban tri nene dhe përcakton procedurat e varrimit dhe rivarrimit i mbetjeve mortore të dëshmorit.

Relacion për projekt-udhëzimin “Për miratimin e formatit të kërkesës, llojet e dokumenteve që paraqiten për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut”, si dhe kushtet teknike të plotësimit të tyre”.

- Neni 18 përcakton organet kërkuese dhe vendimmarrëse për varrimet dhe rivarrimet e mbetjeve mortore të dëshmorëve të atdheut në varrezat e dëshmorëve të atdheut në kryeqytet dhe në qarqet përkatës. Këtu theksohet ndër të tjera që varrimi i dëshmorit të atdheut apo rivarrimi i mbetjeve mortore të tij në varrezat e dëshmorëve të atdheut “Nëna Shqipëri”, në kryeqytet bëhet me vendim të KQSDA-së, bazuar në kërkesën dhe dokumentet shoqëruese të dërguara nga këshillat bashkiakë, këshilli i qarkut, prefekti apo ministri.

- Neni 19 përcakton dokumente që paraqiten nga organet shtetërore pranë KQSDA-së për varrimin apo rivarrimin e mbetjeve mortore të dëshmorit të atdheut në varrezën e dëshmorëve të atdheut “Nëna Shqipëri”, në kryeqytet.

- Neni 20 përcakton dokumentet që paraqiten nga subjektet kërkuese pranë këshillit bashkiak, këshillit të qarkut apo prefektit për varrimin apo rivarrimin e mbetjeve mortore të dëshmorit të atdheut në varrezën e dëshmorëve të atdheut në qarkun përkatës.

9. Kreu IX përbëhet nga tri nene dhe përcakton të drejtën e ankimit dhe dokumentet që duhet të dorëzohen.

- Neni 21 përcakton ankimin pranë KQSDA-së kundër vendimit të këshillit bashkiak, këshillit të qarkut apo prefektit që refuzon të pranojë kërkesën për statusin e dëshmorit të atdheut ose kur këto organe nuk marrin në shqyrtim kërkesën brenda afateve të parashikuara nga ligji nr.109/2018 “Për statusin e dëshmorit të atdheut” (3 muaj), si dhe ankimin në gjykatën administrative kundër vendimit të KQSDA-së, gjithashtu edhe kur ky komision nuk shprehet brenda afateve të përcaktuara në pikën 6, të nenit 10, të ligjit nr.109/2018 “Për statusin e dëshmorit të atdheut”.

- Neni 22 përcakton dokumentet që paraqiten nga ankuesi pranë KQSDA-së, kundër vendimit të këshillit të bashkiak, këshillit të qarkut apo prefektit të qarkut. Gjithashtu në këtë nen përcaktohen edhe dokumentet që paraqiten nga ankuesi në KQSDA kundër vendimit të këshillit të qarkut, këshillit të bashkisë apo prefektit, ose kur këto organe nuk marrin në shqyrtim kërkesën brenda afateve ligjore.

- Neni 23 përcakton dokumentet që kërkohen për kryerjen e hetimit administrativ nga Komisioni Qendror për zgjidhjen e ankesës administrative drejtuar KQSDA-së.

10. Kreu X përmban dy nene dhe përcakton kushtet teknike të plotësimit të dokumenteve dhe përcaktimi juridik i vlefshmërisë së tyre

- Neni 24 përcakton kushtet teknike të plotësimit të dokumenteve që paraqiten për statusin e “Dëshmorit të atdheut”, kushtet teknike që duhet të plotësojnë, kërkesa për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut”, kushtet teknike që duhet të plotësojnë dokumentet e lëshuara nga institucionet arkivore dhe muzetë, kushtet teknike për dokumentet e propozimit për shpalljen “Dëshmor i atdheut”, si dhe kushtet teknike të të gjitha dokumenteve të marra nga institucionet e shteteve të huaja.

Relacion për projekt-udhëzimin “Për miratimin e formatit të kërkesës, llojet e dokumenteve që paraqiten për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut”, si dhe kushtet teknike të plotësimit të tyre”.

Në këtë nen përcaktohet që organet zyrtare të cilat nuk disponojnë dokumentet e kërkuara sipas këtij udhëzimi, subjektet kërkuese duhet të paraqesin vërtetimin negativ.

- Neni 25 përmban përcaktimin juridik të vlefshmërisë së dokumenteve.

11. Kreu XI përmban një nen dhe përcakton aktet ligjore dhe nënligjore për statusin “Dëshmor i atdheut”.

- Neni 26 përcakton aktet ligjore dhe nënligjore për statusin “Dëshmor i atdheut”.

12. Dhe së fundmi, **kreu XII** përmban dispozitat e fundit dhe kalimtare.

VI. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij akti ngarkohet Komisioni Qendror i Statusit “Dëshmorit i Atdheut, këshillat e qarqeve, këshillat e bashkive, prefektët, si dhe komisionet vendore të ngritura pranë tyre.

VII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projekt-udhëzim është hartuar nga grupi i punës, ngritur me urdhër të ministrit të Mbrojtjes nr.1155, datë 30.06.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e udhëzimit “Për miratimin e formatit të kërkesës dhe llojet e dokumenteve që i paraqiten për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut”.


Ky projekt-udhëzim do të dërgohet për mendim pranë Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Brendshme, këshillave të qarqeve, këshillave të bashkive, si dhe prefektëve të qarqeve

VIII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky akt nuk ka efekte financiare për buxhetin e shtetit.

MINISTRI

Niko Peleshi



Relacion për projekt-udhëzimin “Për miratimin e formatit të kërkesës, llojet e dokumenteve që paraqiten për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut”, si dhe kushtet teknike të plotësimit të tyre”.